

## FORMULARI I PËRSHKRIMIT TË PUNËS

### I. TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS

**Emërtesa e pozicionit:** Shef i Sektorit Teknik dhe i Ndërveprimit Hekurudhor

**Institucioni:** Hekurudha Shqiptare sh.a.

**Njësia:** Njësia e Biznesit të Mallrave (NJBM)

**Spektori:** Spektori Teknik dhe i Ndërveprimit Hekurudhor

**Raporton tek:** Drejtori i Njesisë së Biznesit të Mallrave

### II. MISIONI

Të organizojë, drejtojë, koordinojë dhe kontrollojë veprimtarinë teknike dhe operacionale të transportit hekurudhor të mallrave, duke garantuar gatishmërinë teknike të mjeteve lëvizëse, sigurinë e operimit, mirëmbajtjen e inventarit teknik dhe ndërveprimin me strukturat e brendshme dhe të jashtme të sektorit hekurudhor, në përputhje me legjislacionin, rregulloret dhe standardet në fuqi.

### III. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS

Sigurimi i funksionimit të qëndrueshëm dhe efikas të transportit hekurudhor të mallrave nëpërmjet planifikimit, koordinimit dhe monitorimit të proceseve teknike, mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse, administrimit të inventarit teknik dhe garantimit të respektimit të standardeve të sigurisë dhe ndërveprimit hekurudhor.

### IV. DETYRAT KRYESORE

a. Organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Sektorit Teknik dhe të Ndërveprimit Hekurudhor. Koordinon punën me strukturat e lëvizjes dhe kontrollit të trafikut për qarkullimin e trenave të mallrave.

Ndjek realizimin e grafikëve të transportit dhe koordinon zgjidhjen e problematikave operacionale.

b. Planifikon dhe monitoron programet e mirëmbajtjes dhe riparimit të lokomotivave dhe vagonave.

Mbikëqyr gatishmërinë teknike të mjeteve lëvizëse dhe ndjek eliminimin e defekteve teknike.

Administron inventarin teknik të mjeteve lëvizëse dhe evidenton ndryshimet përkatëse.

c. Harton raporte, analiza teknike dhe statistika mbi performancën e mjeteve lëvizëse dhe transportit të mallrave.

Analizon treguesit teknikë dhe operacionale të sektorit.

Propozon masa për përmirësimin e eficiencës dhe uljen e kostove operative.

ç. Siguron respektimin e rregullave të sigurisë së lëvizjes, mbrojtjes në punë dhe mbrojtjes nga zjarri.

Merr pjesë në hartimin dhe përditësimin e rregulloreve, procedurave dhe udhëzimeve teknike.

Koordinon veprimet me operatorët hekurudhorë dhe administruesit e infrastrukturës.

d. Bashkëpunon me Njësinë e Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse dhe strukturat e tjera për mirëadministrimin e mjeteve hekurudhore.

Monitoron proceset e hyrjes, riparimit dhe daljes së mjeteve nga mirëmbajtja.

Mbështet proceset e planifikimit të kapaciteteve transportuese.

dh. Kryen detyra të tjera funksionale sipas urdhrave dhe udhëzimeve të Drejtorit të Njesisë së Biznesit të Mallrave.

## V. PËRGJEGJËSITË KRYESORE LIDHUR ME:

### A. Planifikimin dhe objektivat

- A.1 Planifikon aktivitetet vjetore dhe periodike të sektorit në përputhje me objektivat e NJBM-së.
- A.2 Monitoron realizimin e treguesve teknikë dhe operacionale të sektorit.
- A.3 Harton propozime për përmirësimin e performancës teknike dhe operacionale.

### B. Menaxhimin

- B.1 Organizon dhe koordinon punën e stafit të sektorit.
- B.2 Siguron përdorimin racional të burimeve njerëzore dhe teknike.
- B.3 Kontrollon realizimin e detyrave dhe zbatimin e procedurave të punës.

### C. Detyrat teknike

- C.1 Monitoron gjendjen teknike të mjeteve lëvizëse dhe realizimin e mirëmbajtjes.
- C.2 Analizon problematikat teknike dhe propozon masa korrigjuese.
- C.3 Siguron zbatimin e standardeve teknike dhe procedurave operative.

### D. Përfaqësimin institucional dhe bashkëpunimin

- D.1 Përfaqëson sektorin në takime teknike dhe profesionale.
- D.2 Bashkëpunon me strukturat e tjera të Hekurudha Shqiptare sh.a.
- D.3 Bashkërendon veprimet me operatorët hekurudhorë, administruesit e infrastrukturës dhe institucionet e tjera të sektorit.

## VI. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

Analizon problematikat teknike dhe operacionale të sektorit, identifikon shkaqet dhe propozon masa për zgjidhjen e tyre në përputhje me procedurat dhe rregulloret në fuqi.

## VII. VENDIMMARRJA

Merr vendime operative brenda kompetencave të pozicionit për organizimin e punës së sektorit, koordinimin e proceseve teknike dhe administrimin e mjeteve lëvizëse.

Propozon masa teknike dhe organizative për përmirësimin e performancës së sektorit.

## VIII. MJEDISI MENAXHERIAL

Ushtron funksionet në bashkëpunim të vazhdueshëm me Drejtorin e NJBM-së, Njësinë e Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse, strukturat e trafikut dhe njësitë e tjera të Hekurudha Shqiptare sh.a.

## IX. MBIKËQYRJA

Mbikëqyr zbatimin e detyrave të sektorit, realizimin e objektivave dhe respektimin e procedurave teknike dhe operacionale.

## **X. STAFI NËN VARËSI**

Specialistët dhe punonjësit e Sektorit Teknik dhe të Ndërveprimit Hekurudhor.

## **XI. KUSHTET E PUNËS**

Punë administrative dhe teknike në ambientet e NJBM-së.

Inspektime dhe kontrole periodike në terren.

Pjesëmarrje në takime teknike dhe operative.

Kryerje e udhëtimeve të punës brenda dhe jashtë vendit sipas nevojave të detyrës.

## **XII. KËRKESAT E POSAÇME**

Arsimi:

Diplomë universitare në Inxhinieri Transporti, Inxhinieri Hekurudhore, Inxhinieri Mekanike, Inxhinieri Elektrike, Inxhinieri Ndërtimi ose fusha të ngjashme.

Përvoja:

Minimumi 5 vite përvojë profesionale në fushën e transportit, logjistikës, mirëmbajtjes së mjeteve teknike ose operacioneve hekurudhore.

Përvoja në pozicione drejtuese ose koordinuese përbën avantazh.

Tjetër:

Njohuri shumë të mira të paketës Microsoft Office.

Njohuri të gjuhës angleze në nivel pune (minimumi niveli B1).

Njohuri mbi legjislacionin hekurudhor dhe procedurat e sigurisë së lëvizjes.

Aftësi të mira organizative, menaxheriale, analitike dhe raportuese.

**HEKURUDHA SHQIPTARE SH.A.**

**DURRËS, 18/06/2026**

**NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

Shoqëria Hekurudha Shqiptare sh.a. njofton kandidatët e interesuar për vendin vakant të punës në pozicionin:

**Shef i Sektorit Teknik dhe i Ndërveprimit Hekurudhor  
Njësia e Biznesit të Mallrave**

**Kriteret e përgjithshme të kandidatit, sipas:**

1. Të jetë shtetas shqiptar dhe të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të jetë në kushte shëndetësore që lejojnë ushtrimin e detyrës përkatëse.
3. Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
4. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, e pafshirë sipas legjislacionit në fuqi.
5. Të ketë përgatitjen arsimore, profesionale dhe përvojën e kërkuar për pozicionin përkatës.

**Afati i dorëzimit të dokumentacionit është data 29 /06/2026.**

Adresa:

*Hekurudha Shqiptare sh.a.*

*Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse*

*Rr. Egnatia, Lagjja Nr. 3, Godina Nr. 8, Durrës*

**Kriteret e veçanta të pozicionit të punës:**

- a. Të zotërojë diplomë të Arsimit të Lartë (Master Shkencor ose ekuivalent) në Inxhinieri Transporti, Inxhinieri Hekurudhore, Inxhinieri Mekanike, Inxhinieri Elektrike, Inxhinieri Ndërtimi ose fusha të ngjashme.
- b. Të ketë jo më pak se 5 (pesë) vite përvojë profesionale në sektorin e transportit, logjistikës, mirëmbajtjes së mjeteve teknike ose operacioneve hekurudhore.
- c. Përvoja në sektorin hekurudhor, transportin e mallrave, administrimin e mjeteve lëvizëse ose menaxhimin e proceseve operacionale përbën avantazh.
- d. Të ketë njohuri mbi organizimin dhe funksionimin e transportit hekurudhor të mallrave.
- e. Të ketë njohuri mbi mirëmbajtjen, riparimin dhe administrimin e lokomotivave dhe vagonave.
- f. Të ketë njohuri mbi rregullat e sigurisë së lëvizjes së trenave dhe procedurat operative hekurudhore.
- g. Të ketë njohuri mbi legjislacionin hekurudhor dhe aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë hekurudhore.
- h. Të ketë aftësi për planifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve të mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse.

- i. Të ketë aftësi për analizimin e treguesve teknikë dhe operacionalë, hartimin e statistikave, raporteve dhe analizave periodike.
- j. Të ketë aftësi për administrimin dhe kontrollin e inventarit të mjeteve lëvizëse dhe burimeve teknike.
- k. Të ketë aftësi drejtuese, organizative dhe koordinuese për menaxhimin e veprimtarisë së sektorit.
- l. Të ketë aftësi për marrjen e vendimeve dhe zgjidhjen e problematikave teknike dhe operacionale.
- m. Të ketë aftësi bashkëpunimi me Njësinë e Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse, Njësinë Qendrore të Kontrollit të Trafikut, njësitë rajonale dhe strukturat e tjera të shoqërisë.
- n. Të zotërojë njohuri shumë të mira të paketës Microsoft Office (Word, Excel, Outlook dhe PowerPoint).
- o. Të zotërojë njohuri të gjuhës angleze në nivel pune (minimumi niveli B1), kusht i detyrueshëm për aplikim.
- p. Të ketë aftësi për të kuptuar dhe përdorur dokumentacion teknik dhe profesional në gjuhën angleze.
- q. Të jetë i gatshëm për kryerjen e inspektimeve në terren, kontrolleve teknike dhe udhëtimeve të punës sipas nevojave të pozicionit.
- r. Të gëzojë integritet të lartë profesional, etikë në punë dhe aftësi për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit zyrtar.

**Lista e dokumentacionit të punës, për t'u dorëzuar nga kandidati/ja si vijon:**

- Kërkesë për aplikim (Letër Interesi drejtuar institucionit);
- Curriculum Vitae (CV) e detajuar dhe e përditësuar;
- Fotokopje e Kartës së Identitetit ose Pasaportës;
- Fotokopje e diplomës universitare dhe suplementit/listës së notave;
- Dokumentacion që vërteton përvojën profesionale (librezë pune, vërtetime pune ose ekstrakt i sigurimeve shoqërore);
- Dëshmi Penaliteti (mund të paraqitet nga kandidati fitues para emërimit);
- Fotokopje të certifikatave, trajnimeve ose kualifikimeve profesionale, nëse disponohen;
- Çdo dokument tjetër që kandidati e gjykon të vlefshëm për vlerësimin e aplikimit.

Procedura që do të ndiqet është e hapur për të gjithë dhe kriteret e përzgjedhjes do të zbatohen nga Komisioni Përzgjedhës.

Intervista me kandidatët që plotësojnë kriteret dhe kalojnë fazën e vlerësimit paraprak të dokumentacionit do të zhvillohet në Durrës, Lagjja Nr. 3, Godina e Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudha Shqiptare sh.a.

**JU FALEMINDERIT!**

**HEKURUDHA SHQIPTARE SH.A.**